

**Njoftim për përqendrim me të cilin Telekomunikatii Republika Srpska, Bosnjë dhe
Hercegovinë do të fitojë kontroll mbi KTV E-G-E sh.p.k. Doboj Jug, Bosnjë dhe
Hercegovinë**

(Lënda nr. 08-157 /2025)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 05.11.2025, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin Telekomunikatii Republika Srpska shoqëri aksionare Banja Luka, me seli të regjistruar në rr. Vuka Karaxhiq nr. 2 Banja Luka, Bosnjë dhe Hercegovinë, do të fitojë kontroll të drejtpërdrejtë individual mbi KTV E-G-E sh.p.k. Doboj Jug, me seli të regjistruar në rr. Trg 21. Mart nr. 18, Matuziqi, Doboj Jug, Federata e BeH, Bosnjë dhe Hercegovinë („Shoqëria e synuar”).

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe veprimtaritë e tyre afariste

Telekomunikatii Republika Srpska është operator për shërbime dhe rrjete të komunikimeve elektronike, i regjistruar për telekomunikime kablllore, i njëjti ofron shërbime të telefonisë fikse dhe celulare, internet dhe shërbime multimediale në territorin e Bosnjës dhe Hercegovinës.

Telekomunikatii Republika Srpska është në pronësi shumicë të Telekom Srbija, shoqëri aksionare Beograd, Serbi.

Subjekt i lidhur i Telekom Srbija në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut është Shoqëria për tregti dhe shërbime MTEL SHPKNJP Shkup, selia e së cilës është e regjistruar në rrugën "Maksim Gorki" 11/1-3, Shkup, Qendër, e regjistruar për veprimtarinë e telekomunikimeve me tela, përkatësisht për ofrimin e shërbimeve në vijim: rrjet publik i radio-komunikimit, qasje në internet me brez të gjerë (broadband), shërbime ndër-operatorësh, ritransmetim të programeve televizive dhe shërbime satelitore.

Subjekti i lidhur i MTEL SHPKNJP Shkup është Shoqëria për telekomunikime MTELMOBIL SHPKNJP Shkup.

Gjithashtu, subjekt i lidhur i Telekomunikatii Republika Srpska në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut është Shoqëria për tregti dhe shërbime TOTAL TV SHPK Shkup, me seli në Bulevardin Partizanski Odredi nr. 17, 1-001/Shkup – Qendër, Qendër, në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e regjistruar për veprimtarinë e telekomunikimeve satelitore.

KTV E-G-E sh.p.k. Doboj Jug është operator i shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike, i regjistruar për ofrimin e qasjes në internet dhe shërbime interneti, distribuim të përmbajtjes mediatike.

KTV E-G-E sh.p.k. Doboj Jug nuk ka persona juridikë të lidhur në territorin e Maqedonisë së Veriut, dhe as nuk ka realizuar të ardhura në atë territor.

Për qëllimet e vlerësimit të këtij përqendrimi, parashtruesi i njoftimit propozon që si treg relevant të përkufizohet tregu i ofrimit të shërbimeve të qasjes fikse në internet me brez të gjerë (broadband) dhe tregu i ofrimit të shërbimeve të distribuimit të përmbajtjes mediatike.

Bazuar në shqyrtimin paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të dorëzojnë vërejtjet dhe mendimet e tyre për këtë përqendrim deri te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. "Shën. Kirili dhe Metodi" nr. 54, Shkup ose me e-mail: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë në Komision brenda 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

12.11.2025 Shkup